

Nexhmedin Spahiu

Kosova tani ka tre kryeministra: Njëri formal (Isa Mustafa) dhe dy bashkëkryeministra faktikë (Thaçi e Vuçiq).

Çdo qeveri ngjallë shpresa te ndonjë pjesë e qytetareve. Në disa raste të ndonjë pjese më të madhe, e në disa raste të ndonjë pjesë më të vogël. Por, ngjallë shpresa. E kjo qeveri nuk po i ngjallë shpresa askujt.

Kur u formua blloku LAN, patëm festë nëpër rrugët Prishtinës. Flamujt e LDK-së, Nismës e AAK u bashkuan dhe simpatizantët e tyre e madje edhe njerëzit pa parti festonin, sepse kishte shpresë për ndryshim.

Natyrisht, simpatizantët e PDK-së ishin të zymtë, por 70 për qind të qytetareve u gëzuan.

Me qeverinë aktuale nuk u gëzua askush. Simpatizantët e LDK-së janë ba me e vra veten. Në princip do të duhej të gëzoheshin, por ata po ndjehen më keq se kur LDK ishte opozitë. Simpatizantët e PDK-së sado që e dinë së Isa Mustafa është vetëm formalisht kryeministër dhe lideri i tyre Thaçi i ka penjtë në dorë, janë të ngrysur nga fakti që Thaçi nga kryeministër faktik e formal tani më nuk është kryeministër formal.

Parakushti që më pasë dobi prej një qeverie është që ajo fillimisht me ngjallë shpresa. Kjo qeveri as shpresa nuk po ngjallë. Ajo do të jetë kombinim dhe shumëfishim i dështimeve të deritanishme.